DEKLARATË
Për Mbrojtjen e Lumit të Bënçës

Lumi i Bënçës është një ndër degët e lumit Vjosa dhe ka një gjatësi prej 26 km. Lugina e Bënçës shtrihet midis Trushnicës dhe Buzës së Bredhit. Ajo është një luginë mbresëlënëse e cila merr formë të plotë pas bashkimit të Gurrës së Progonatit me përroin e Nivicës duke formuar lumin e Bënçës, që krijon kanionet me të njëjtin emër, një ekosistem mahnitës me vlera të mëdha biologjike-natyrore, dhe me biodiversitet të spikatur. Këto vlera shërbejnë si bazë për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm pwr komunitetin lokal permes zhvillimit te turizmit.

Në luginën e Bënçës janë parashikuar të ndërtohen 5 HEC-e, 2 prej të cilave kanë filluar punimet, duke rrezikuar monumente të natyrës të mbrojtura me ligj si: Kanionet e Nivicës, Ujëvara e Progonatit, Tarracat erozive e Bënçës, Buza e Bredhit Luzat si dhe integritetin e gjithë ujëmbledhësit të Vjosës, i cili konsiderohet si një nga lumenjtë unik në gjithë kontinentin.

Më tepër se sa përfitime ekonomike, këto projekte janë bërë burim konflikti mes komunitetit lokal dhe kompanive koçesionare duke nxitur revolta jo vetëm të komunitetit përreth dhe por të gjithë banorëve të luginës së Vjosës.

Duke përçuar zërin e komunitetit dhe qindra aktorëve të tjerë të shoqërisë civile të përfshirë në nismën për mbrojtjen e lumit të Bënçës:
Ne, OJF-të shqiptare të poshtëshënuara, si pjesë e nismës “Të mbrojmë lumenjtë” kundërshtojmë fuqimisht projektet e në luginën e Bënçës pasi besojmë se pikërisht kjo luginë përbën potencialisht “zemrën” e një Parku Kombëtar të mundshëm që përfshin gjithë luginën e Vjosës. Në vend të tyre, ne duam të mbrojmë trashëgiminë tonë natyrore.

Ne kërkojmë, që Qeveria Shqiptare të angazhohet në mbrojtjen e këtij lumi duke ndaluar projektet e ndërtimit të hidrocentraleve për stabilizuar një bashkëjetesë harmonike mes shoqërisë, natyrës dhe shkencës.

Nënshkruar nga:

EcoAlbania	Qendra **EcoAlbania**
REC Shqipëri	**Q**endra **R**ajonale e **M**jedisit - Shqipëri (**REC-Albania**)
INCA	**I**nstituti për **R**uajtjen e **N**atyrës në **S**hqipëri **(INCA)**
EDEN Qendra Mjedisore	Qendra **EDEN**
Ekolëvizja	Qendra **Grupimi Ekolëvizja**
Milieukontakt Albania	**Milieukontakt - Albania**
SHBO	**Sh**oqata e **B**ujqësisë **O**rganike (**SHBO**)
EPER Center Albania	**Q**endra **M**jedisore për **M**brojtje, **E**dukim dhe **R**ehabilitim (**EPER**)
ACERC Albanian Centre for Energy Regulation & Conservation	**Q**endra për **Rr**egullimin dhe **R**uajtjen e **E**nergjisë në **Sh**qipëri (**ACERC**)

PSEDA - ILIRIA	**PSEDA - ILIRIA**
INSTITUTI I POLITIKAVE MJEDISORE INSTITUTE FOR ENVIRONMENTAL POLICY	**I**nstituti i **P**olitikave **M**jedisore
AJMMI	**A**gjencia **J**oniane e **M**jedisit, **M**edias dhe **I**nformacionit (**AJMMI**)